

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” ky dokument perben:

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I  
SHOQERISE  
“CHICKEN ISLAND GROUP”**

**Sot me date 19 Mars 2018, ne Shkoder,**

- Blerta Lushi, shtetase shqiptare, lindur me 29.05.1979, ne Shkoder, Shqiperi, mbajtese e kartes se identitetit me Nr. Personal H 95529025 K , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Vendosa te nenshkruaj kete Akt Themelimi dhe Statutin e meposhtem per krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar , aktiviteti i se ciles te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i meposhtem.



**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE**  
**( “Statuti”)**  
**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**  
**“CHICKEN ISLAND GROUP”SHPK**  
**(“Shoqeria”)**

**Neni 1**  
**Emri i Shoqerise dhe Forma Ligjore**

- 1.1 Ne baze e ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, themelohet Shoqeria **“CHICKEN ISLAND GROUP” SHPK** e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi **“SHPK”** e cila perfaqeson formen juridike te saj, te ciles ketej e tutje do ti referohemi si **“Shoqeria”**.
- 1.2 Shoqeria eshte nje person juridik Shqiptar, qe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008” Per Tregtaret dhe Shoqeri Tregtare” (Ligji per Shoqerite“).
- 1.3 Shoqeria fiton personalitetin juridik nga momenti i rregjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (“QKB”), ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 1.4 Ortaket e Shoqerise gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e kontributeve perkatese te tyre ne kapitalin e perfaqesuar ne kuota.
- 1.5 Ne cdo dokument, fatura, shpallje apo publikime te bera nga Shoqeria , pamvarsisht nga menyra e transmetimit, emri i Shoqerise duhet te shoqerohet ose te ndiqet nga:
  - a. Fjalet **“Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”** ose **“SHPK”**
  - b. Numri unik i identifikimit (NIPT):
  - c. Seline e regjistruar dhe zyren qendrore: dhe
  - d. Te dhena nese Shoqeria eshte ne proces likuidimi.



## **Neni 2**

### **Selia**

Ne momentin e miratimit te ketij Statuti , Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Berdise e Mesme , truall me nr pasurie 479/6, zona kadastrale 1158 .Shoqeria me vendim te Asamblese se Pergjithshme mund te zhvendose seline e saj ose te krijoje nje qender operative ne nje vend tjetër ne Republikën e Shqipërisë, Shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi ne cdo vend brenda ose jashte Republikës se Shqipërisë, sipas gjykimit te Asamblese se Pergjithshme.

## **Neni 3**

### **3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:**

Krijimi dhe menaxhimi i impianteve te rritjes, perpunimit, therjes, mbareshtimit dhe tregtimit te pulave, mishit te pules dhe produkteve te pules, apo te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohet ne tregun vendas dhe te huaj: Zhvillimi i teknologjive te reja ne fushen e rritjes, perpunimit, therjes, mbareshtimit dhe tregtimit te pulave, te plota apo pjeseve te tyre, por edhe te produkteve te tjera te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohen ne tregun vendas dhe te huaj. Importi dhe eksporti i ketyre produkteve, kryesisht pulave te gjalla dhe ato te mishit te pules, te plota apo te pjeseve te tyre, gjithashtu edhe te produkteve te pules, vecanerisht vezeve te saj, por edhe produkteve te tjera te te gjitha kafsheve, mishi i te cilave tregtohen ne tregun vendas dhe te huaj, si psh mish vici, derri, lope etj. Import dhe eksport i lendeve te para ose produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve. Importi dhe eksporti i makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per impiantet e rritjes, perpunimit, therjes, mbareshtimit dhe tregtimit te pulava, mishi i te cilave tregtohen ne tregun vendas dhe te huaj. Importi dhe eksporti i makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin e nenprodukteve te mishit te te gjitha llojeve te kafsheve. Furnizim dhe tregtimi ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjitha produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise. Importi i desinfektanteve ushqimore, vaksinave te ndryshme te shpendev, kafsheve dhe te gjitha produktetve te tjera medicinale te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te rritjes se kafsheve.



## **Neni 4**

### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, por gjithsesi mbi 10 vjet

#### **Neni 5 Ortakët**

Ne momentin e miratimit të këtij statuti ortaku i vetëm i Shoqërisë është znj. Blerta Lushi.

#### **Neni 6 Kapitali i Regjistruar**

##### **Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

6.1 Kapitali i shoqërisë është 100.000, i ndarë në 1 kuotë dhe është plotësisht e nënshkruar dhe i shlyer.

6.2 Kuota është e pjestueshme, e transferueshme, e trashëgueshme në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Ajo transferohet në përputhje me Ligjin për shoqëritë dhe regjistrohet në Qendren Kombëtare të Biznesit si dhe në Librin e Ortakeve.

#### **Neni 7**

##### **Lenia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit**

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshem tek persona të tjerë, në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Ai mund të lihet peng sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshem në rrugë trashëgimie. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të bëhet me akt noterial.

#### **Neni 8**

##### **Struktura, organet drejtuese dhe administrimi i shoqërisë**



## **Ortaku i vetem**

Si organ i vetem administrues, drejtues dhe perfaqesues i shoqerise, sipas kerkesave ligjore, eshte ortaku i vetem

## **Kompetencat e ortakut te vetem te shoqerise**

Kompetencat e ortakut te vetem do te jene:

1. Realizon administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me personat e tjere juridike ose fizike.
2. Vendos per ndryshimet ne statutin e shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise
3. Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te vecante te veprimtarise
4. Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj
5. Emeton dhe shkarkon administratorin/et e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne statut
6. Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit si dhe shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
7. Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit
8. Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e kredive
9. Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike ose juridike
10. Vendos per mbarimin e shoqerise, likuidimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera
11. Realizon maredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere juridike apo fizike, vendas apo te huaj
12. Vendos cmimet e shitjes, te sherbimeve etj
13. Vendos per pagat e te punesuarve ne shoqeri etj

**Neni 9**

**Administratorët**



### **Emërimi i Administratorëve**

Zgjidhet si administrator i vetem i shoqërisë z. Blerta Lushi për një periudhë 5 vjeçare. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

### **Kompetencat e Administratorëve**

Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të

gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Ortakut të Vetem sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Ortaku i Vetem dhe udhëzimet e Ortakut të Vetem nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pague;se;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa arsye

## **Neni 10**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Dividendët**

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e



maturimit, në rast se vendoset nga Ortaku, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### **Neni 11**

##### **Bilanci**

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel autorizuar nga ortaku i vetëm miratohen nga vete ortaku e vetëm.

#### **Neni 12**

##### **Prishja dhe njoftimet**

##### **Mbarimi**

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

##### **Likuidimi**

Shoqëria hyn në proces likuidimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortakut i Vetëm cakton një ose më shumë likuidatore, të cilët i paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit, ortakut i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve, Ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

#### **Neni 13**

##### **Dispozita të fundit**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do të paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Shoqëria do të ketë vullnetin e saj, formën dhe madhësinë e të cilës do të përcaktohen nga ortakut i vetëm.

**Ortakut i Vetëm:**

**Blerta Lushi**

